

Statistika mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, 2017


Viti 2017

Tiranë, më 12 Mars 2019: Statistikat për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) bazuar në rezultatet e vrojtimit të Statistikave Strukture, për vitin 2017, shprehin se:

- **99,8 % të ndërmarrjeve aktive** e zënë NVM, nga 99,9 % që zinin vitin e kaluar. Sektori i tregtisë ka peshën më të madhe me 41,4 %, i ndjekur nga sektori i shërbimeve të tjera me 20,8 %. Përqindjen më të ulët e ka sektori i industrisë nxjerrëse me 0,4 % dhe sektori i energjisë elektrike, ujit dhe menaxhimit të mbetjeve me 0,6 %.
- **80,3 % e të punësuarve** janë punësuar nga NVM nga 81,0 % që ishte në vitin e kaluar. Sektori i tregtisë punëson 29,2 % të NVM-ve, i ndjekur nga sektori i shërbimeve të tjera me 19,6 % dhe sektori i industrisë përpunuese me 18,7 %. Sektorët me numrin më të vogël të të punësuarve në NVM-të janë sektori i industrisë nxjerrëse me 1,7 % dhe sektori i energjisë elektrike, ujit dhe menaxhimit të mbetjeve me 2,4 %
- **77,2 % të shitjeve neto** realizohen nga NVM nga 77,8 % të realizuara vitin e kaluar. Sektori i tregtisë ka peshën më të madhe me 52,6 % të shitjeve neto, i ndjekur nga sektori i industrisë përpunuese me 11,4 % dhe nga sektori i ndërtimit me 11,2 %. Sektori me përqindjen më të ulët të shitjeve të realizuara nga NVM-të është sektori i industrisë nxjerrëse me 2,1 %.
- **60,1 % të investimeve** në vend kryhen nga NVM nga 74,9 % të kryera vitin e kaluar. Sektori me përqindjen më të lartë të investimeve të kryera në NVM-të është sektori i energjisë elektrike, ujit dhe menaxhimit të mbetjeve me 24,1 %. Nga ana tjetër, sektori i industrisë nxjerrëse ka përqindjen më të ulët të investimeve prej 1,3 %.
- **Ndërmarrjet me 250+ të punësuar** edhe pse përbëjnë vetëm 0,2 % të ndërmarrjeve gjithsej në vend, punësojnë 19,7 % të punonjësve, kryejnë 39,9 % të investimeve dhe realizojnë 22,8 % të shitjeve neto.

Tab.1 Treguesit kryesorë dhe struktura e tyre sipas madhësisë së ndërmarrjes, 2017

Madhësia e ndërmarrjes	Ndërmarrjet		Të punësuarit		Shitjet neto		Investimet		Vlera e Shtuar	
	nr.	%	nr.	%	mln Lekë	%	mln Lekë	%	mln Lekë	%
Gjithsej	107.677	100	492.913	100	2.037.349	100	231.713	100	525.642	100
NVM (1-249 të punësuar)	107.511	99,8	395.563	80,3	1.573.851	77,2	139.322	60,1	358.875	68,3
Mikrondërmarrje	101.595	94,4	192.817	39,1	415.729	20,4	31.868	13,8	105.530	20,1
Nd. Vogla	4.839	4,4	95.574	19,5	665.779	32,6	41.815	18,0	125.197	23,8
Nd. Mesme	1.077	1,0	107.171	21,7	492.343	24,2	65.640	28,3	128.148	24,4
Nd. Mëdha (250+ të punësuar)	166	0,2	97.350	19,7	463.497	22,8	92.390	39,9	166.768	31,7

Fig.1 Kontributi i NVM dhe ndërmarrjeve të mëdha në ndryshimin vjetor të treguesve kryesorë, 2017/2016

Në Shqipëri numri i ndërmarrjeve në NVM është 99,8 %, i njëjtë me BE. Numri i të punësuarve në këtë grup ndërmarrjesh është 80,3 % në Shqipëri nga 66,4 % në BE. Vlera e shtuar e realizuar nga NVM në Shqipëri përbën 68,3 % nga 56,8 % në BE.

Tab.2 Struktura e treguesve kryesorë sipas madhësisë së ndërmarrjes në Shqipëri dhe BE, 2017

Madhësia e ndërmarrjes	Nr. Ndërmarrjeve		Të punësuarit		Vlera Shtuar	
	Shqipëri	BE (28 shtetet)	Shqipëri	BE (28 shtetet)	Shqipëri	BE (28 shtetet)
Gjithsej	100	100	100	100	100	100
NVM (1-249 të punësuar)	99,8	99,8	80,3	66,4	68,3	56,8
Mikrondërmarrje (1-9 të punësuar)	94,4	93,1	39,1	29,4	20,1	20,8
Nd. Vogla (10-49 të punësuar)	4,4	5,8	19,4	20,0	23,8	17,6
Nd. Mesme (50-249 të punësuar)	1,0	0,9	21,7	17,0	24,4	18,3
Nd. Mëdha (250+ të punësuar)	0,2	0,2	19,7	33,6	31,7	43,2

Komente mbi tregtinë e jashtme të mallrave në NVM, 2017


- 2,7 % e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme eksportojnë mallra nga 2,4 % që eksportuan në vitin 2016. Vlera e eksporteve të mallrave të NVM përbën 59,6 % të vlerës së eksporteve gjithsej. Sektori me përqindjen më të lartë të ndërmarrjeve eksportuese është industria nxjerrëse, ku 24,4 % e ndërmarrjeve aktive të këtij sektori eksportojnë.
- 9,3 % e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme janë importuese nga 7,4 % që ishin në 2016, të cilat përbënë 81,6 % të vlerës së importeve të mallrave për 2017. Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, sektori me përqindjen më të lartë të numrit të ndërmarrjeve importuesve është sektori i industrisë nxjerrëse me 20,3 %.

Tab.3 Struktura e treguesve të tregtisë së jashtme të mallrave, sipas madhësisë së ndërmarrjes, 2017

Madhësia e ndërmarrjes	Nr Ndërmarrjeve Eksportuese	Nr Ndërmarrjeve Importuese	Vlera e Eksportit	Vlera e Importit
Gjithsej	100	100	100	100
NVM (1-249 të punësuar)	96,9	98,6	59,6	81,6
Mikrondërmarrje (1-9 të punësuar)	49,2	67,6	5,2	19,2
Nd. Vogla (10-49 të punësuar)	32,7	23,5	18,0	30,2
Nd. Mesme (50-249 të punësuar)	15,0	7,5	36,4	32,2
Nd. Mëdha (250+ të punësuar)	3,1	1,4	40,4	18,4


- Rreth 9,9 % e shitjeve neto të NVM shkojnë për eksport. Ndërmarrjet e mesme kryejnë përqindjen më të lartë të eksporteve me 19,2 % të shitjeve neto të realizuara prej tyre. Mikrondërmarrjet eksportojnë vlerën më të ulët ku rreth 3,3 % të shitjeve neto janë eksportuar.

Fig.2 Përqindja e shitjeve për eksport dhe brenda vendit sipas madhësisë së ndërmarrjeve, 2017




Përqindjen më të lartë të punësimit në mikrondërmarrje me 73,4 %, e zë sektori i akomodimit dhe shërbimit ushqimor. Sektori i ndërtimit ka përqindjen më të lartë të punësimit në ndërmarrjet e vogla me 30,1 %. Sektori i industrisë përpunuese ka përqindjen më të lartë të punësimit në ndërmarrjet e mesme me 37,2 %.

Fig.3 Struktura e punësimit sipas aktivitetit ekonomik dhe madhësisë së ndërmarrjes, 2017



Përqindja më e lartë e **vlërës së shtuar** në mikrondërmarrjet, realizohet në sektorin e akomodimit dhe shërbimit ushqimor me 57,8 %. Sektori i tregtisë ka përqindjen më të lartë me 31,7 %, të realizuar nga ndërmarrjet e vogla. Në sektorin e industrisë përpunuese, ndërmarrjet e mesme realizojnë përqindjen më të lartë të vlerës së shtuar me 38,8 % të realizuar nga ky sektor.

Fig.4 Struktura e vlerës së shtuar sipas aktivitetit ekonomik dhe madhësisë së ndërmarrjes, 2017



Metodologjia

Ky publikim paraqet për përdoruesit, statistika mbi situatën e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) në vitin 2017, bazuar në rezultatet e Anketës Strukturore pranë Ndërmarrjeve. Anketa Strukturore pranë Ndërmarrjeve (ASN) ka për qëllim të ofrojë informacion mbi strukturën ekonomike, financiare dhe karakteristikat kryesore të ndërmarrjeve aktive në vend sipas aktiviteteve ekonomike dhe madhësisë së ndërmarrjes. Bazuar në ligjin Nr. 10042, datë 22.12.2008 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr.8957, datë 17.10.2002 “Për ndërmarrjet e vogla e të mesme”, të ndryshuar, ndërmarrjet klasifikohen në: mikrondërmarrje, ndërmarrje të vogla dhe ndërmarrje të mesme.

Për qëllime statistikore ndërmarrjet e vogla dhe të mesme do të trajtohen vetëm sipas numrit të të punësuarve (matur si të punësuar me kohë të plotë), të cilat klasifikohen si më poshtë:

- mikrondërmarrje: ndërmarrjet me 1 deri 9 të punësuar.
- ndërmarrje të vogla: ndërmarrjet me 10 deri 49 të punësuar.
- ndërmarrje të mesme: ndërmarrjet me 50 deri 249 të punësuar.

Statistikat strukturore të ndërmarrjeve kanë si qëllim të tregojnë strukturën e ndërmarrjeve sipas aktiviteteve ekonomike nëpërmjet të dhënave bazë. Treguesit paraqiten për aktivitetet ekonomike gjithsej, sipas degëve dhe sipas madhësisë së ndërmarrjeve. Statistikat përfshijnë gjithë ndërmarrjet që prodhojnë të mira e shërbime në Shqipëri, për të gjitha format ligjore (nuk përfshihen aktivitetet e bujqësisë, peshkimit , aktivitetet e ndërmjetësimit monetar dhe financiar, administrata publike dhe e mbrojtjes si edhe aktivitetet e organizatave ndërkombëtare). Popullsia është bazuar në ndërmarrjet të cilat sipas regjistrit statistikor janë aktive në dhjetor të vitit referues. Klasifikimi i ndërmarrjeve është bërë sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, NVE Rev.2. Të dhënat i përkasin periudhës vjetore kalendarike. Viti fiskal korrespondon me vitin kalendarik. Për ndërmarrjet me 1-9 të punësuar është marrë mostër me zgjedhje për anketim. Ndërmarrjet me 10 e më shumë të punësuar janë anketuar tërësisht. Grumbullimi i të dhënave është kryer me intervistim të drejtpërdrejtë pranë ndërmarrjeve.

Klasifikimi i ndërmarrjeve sipas madhësisë është bërë sipas numrit të të punësuarve (matur si të punësuar me kohë të plotë). Bazuar në ligjin Nr. 10042, datë 22.12.2008 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr.8957, datë 17.10.2002 “Për ndërmarrjet e vogla e të mesme”, të ndryshuar, ndërmarrjet klasifikohen në: mikrondërmarrje, ndërmarrje të vogla dhe ndërmarrje të mesme.

- Kategoria e mikrondërmarrjeve dhe ndërmarrjeve të vogla e të mesme (NVM) përfshin ato ndërmarrje, ku punësohen më pak se 250 veta dhe që realizojnë një shitje neto dhe/ose një bilanc gjithsej vjetor jo më të madh se 250 milionë lekë.
- Ndërmarrje e vogël quhet një ndërmarrje, ku punësohen më pak se 50 persona dhe e cila ka një shitje neto dhe/ose bilanc gjithsej vjetor jo më të madh se 50 milionë lekë.

- Mikrondërmarrje quhet një ndërmarrje, ku punësohen më pak se 10 persona dhe e cila ka një shitje neto dhe/ose bilanc gjithsej vjetor jo më të madh se 10 milionë lekë.

Për më shumë informacion metodologjik mbi vrojtimin strukturor pranë ndërmarrjeve referohuni link-ut:

<http://www.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-shërbimet/statistikat-strukurore-të-ndërmarrjeve-ekonomike/#tab4>

Për më shumë informacion metodologjik mbi tregtinë e jashtme të mallrave referohuni link-ut:

<http://www.instat.gov.al/al/temat/tregtia-e-jashtme/tregtia-e-jashtme-e-mallrave/#tab4>

Rishikimi i të dhënave

Të dhënat finale të ASN rishikohen në rastet kur:

- Zbatohet një klasifikim i ri aktivitetesh
- Ka ndryshime metodologjike
- Rishikohen peshat

ASN përpiqet të ndjekin udhëzimet standarde dhe parime në rishikimet e bëra në bashkëpunim me asistencën teknike të marrë nga eksperiencat më të mira të vendeve të bashkimit europian.

Politikat e rishikimit të ASN bëhen në përputhje me politikat e rishikimit të vendosura nga INSTAT. Për më shumë referojuni linkut: http://www.instat.gov.al/media/2829/politika_e_revizionimit.pdf

Përkufizime të variablave

Ndërmarrja

Ndërmarrja është njësi më e vogël e kombinimit të njësisë ligjore me njësinë e prodhimit të produkteve ose shërbimeve e cila ka pavarësi në vendim-marrje, sidomos për përdorimin e burimeve të saj materiale e monetare. Një ndërmarrje mund të ushtrojë një ose disa aktivitete ekonomike.

Shitjet neto

Shitjet neto përfshijnë shumat e faturuara për të gjithë aktivitetin e kryer nga njësi që vrojtohet për periudhën referuese dhe kjo korrespondon me vlerën e shitjes së mallrave dhe shërbimeve të tretëve, duke përjashtuar taksën mbi vlerën e shtuar. Ky variabël mund të gjendet në botimet e tjera me termat: shifra e afarizmit ose xhiro.

Numri i të punësuarve

Numri i të punësuarve përfshin të gjithë personat që punojnë në ndërmarrje përfshirë pronarët, të punësuarit me pagesë si dhe pjesëtarët e familjes të papaguar.

Investimet

Investimet gjatë periudhës referuese përfaqësojnë vlerën e mallrave afatgjata të blera prej ndërmarrjeve ose të krijuara për llogari të vet me qëllim përdorimi për një periudhë jo më të vogël se 1 vit në procesin e prodhimit, përfshirë tokën.

Vlera e prodhimit

Prodhimi është një aktivitet i ushtruar nën kontrollin dhe përgjegjësinë e një njësie institucionale (ndërmarrje) që kombinon burimet e fuqisë punëtore, kapitalit dhe lëndës së parë, për të prodhuar të mira dhe kryer shërbime.

Vlera e prodhimit bazohet në:

Të ardhurat nga shitja e produkteve dhe shërbimeve (shitjet neto) të krijuara nga vetë ndërmarrja:

(±) Ndryshimet e gjendjen së produkteve të gatshme dhe në proces.

(±) Ndryshimet në gjendjen e mallrave dhe shërbimeve të blera për rishitje në të njëjtat kushte

(-) Blerjet e mallrave dhe shërbimeve për rishitje në të njëjtat kushte

(+) Prodhimi i aktiveve të qëndrueshme nga ndërmarrja për llogari të vet

(+) Subvencionet.

Konsumi ndërmjetës

Konsumi ndërmjetës përfaqëson vlerën e produkteve ose shërbimeve të transformuara ose plotësisht të konsumuara gjatë procesit të prodhimit. Përdorimi i aktiveve fikse të vëna në punë nuk përfshihet në vlerën e konsumit ndërmjetës.

Vlera e shtuar

Vlera e shtuar me çmime bazë llogaritet si diferencë e vlerës së prodhimit me konsumin ndërmjetës.

Eksportet

Janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, të përpunimit pasiv, të rieksporuara për t'ju nënshtruar përpunimit aktiv.

Importet

Janë në përgjithësi mallra që vijnë nga një vend i tretë dhe të vendosura direkt në magazinat e ruajtjes, nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.